FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

VITAMINA B1

Tableta – 10 mg
Tretësirë për injeksion – 50 mg / 1 ml
(Tiaminë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Vitamina B1 dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Vitamina B1
3. Si ta merrni Vitamina B1
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Vitamina B1
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË VITAMINA B1 DHE PËRSE PËRDORET

Vitamina B1 (tiaminë klorhidrat) bën pjesë në grupin e vitaminave të tretshme në ujë, ndonëse disa rrjedhës të saj kanë një farë lipofiliciteti.
Funksionet themelore të tiaminës klorhidrat janë: metabolizmi i karbohidrateve, zhvillimi normal i organizmit, përçimi i impulseve nervore dhe sinteza e acetilkolinës.
Tiamina është thelbësore për metabolizmin aerob normal. Ajo kombinohet me adenozinë trifosfatin (ATP) në prani të enzimës tiaminëdifosfokinazë, duke dhënë tiaminëpirofosfatin, një koenzimë e rëndësishme që njihet edhe me emrin kokarboksilazë.
Tiaminëpirofosfati është forma vepruese e tiaminës dhe që vepron si koenzimë në metabolizmin e karbohidrateve, ku bën çkarboksilimin e α – ketoacideve (si p.sh. acidi piruvik) dhe të α – ketoglutarateve.
Pamjaftueshmëria e tiaminës shfaqet kur marrja e saj nëpërmjet ushqimit është e papërshtatshme.
Pamjaftueshmëria e rëndë shkakton sëmundjen e beriberit, e cila karakterizohet me çrregullime gastrointestinale dhe neuropati periferike.

Vitamina B1 tableta dhe tretësirë për injeksion përdoret në situatat e mëposhtme klinike:

- profilaksi ose mjekim i pamjaftueshmërisë së tiaminës (beri-beri)
- profilaksi e sindromit Wernicke-Korsakoff
- mjekim i kolitit ulçeroz, i diarresë kronike, i sindromit cerebral, i polineuritit, nxitëse e oreksit.

Përdorimi i injeksionit indikohet kur marrja nga goja është e pamundur ose nuk këshillohet.

2. PËRPARA SE TË MERRNI VITAMINA B1

Mos merrni Vitamina B1 në qoftë se keni mbindjeshmëri të njohur ndaj këtij bari (tiaminës klorhidrat) ose ndaj përbërësve të tjerë të tabletës ose të tretësirës për injeksion.

Tregoni kujdes të veçantë me Vitamina B1
Duhet treguar kujdes për shfaqjen e reaksioneve të mbindjeshmërisë. Në rastin e marrjes së Vitamina B1 në formë tablete, ky fenomen është i rrallë, ndërsa kur përdoret në rrugë parenterale (muskul ose venë), atëherë këshillohet që të bëhet prova intradermale. Janë konstatuar raste vdekjeje nga injektimi në venë i injeksioneve të vitaminës B1.

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Vitamina B1.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Vitamina B1 në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:

- bllokues neuromuskulorë sepse vitamina B1 mund të rrisë efektin e tyre. Rëndësia klinike e këtij fenomeni mbetet e panjohur.
- antiacide sepse pengojnë përthithjen e vitaminës B1.

Marrja e Vitamina B1 me ushqim dhe pije
Shkalla e përthithjes së tabletave Vitamina B1 ndikohet nga marrja e njëkohshme e ushqimeve.

Shtatzënia
Kategoria C.
Nëse jeni shtatzënë, këshillohuni me mjekun përpara se të merrni këtë bar.
Nuk rekomandohet përdorimi i Vitamina B1 gjatë shtatzënisë në doza më të larta se ato të rekomanduara të marrjes me anë të dietës, përveç rastit kur përfitimi tejkalon riskun potencial.
Gjatë shtatzënisë, nevojat për vitaminën B1 janë të rritura, por pavarësisht kësaj, sasia e marrë me dietë zakonisht është e mjaftueshme.

Ushqyerja me gji
Përqëndrimi i vitaminës B1 (tiaminës klorhidrat) në qumështin e gjirit nuk ndikon në mënyrë domethënëse tek fëmija. Mendohet se përdorimi i saj është i pajtueshëm me gjidhënien.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna se Vitamina B1 ndikon në aftësinë për të drejtuar automjetin apo për të përdorur makineri.

Informacion i rëndësishëm për disa nga lëndët ndihmëse të tabletave Vitamina B1
Tabletat Vitamina B1 përmbajnë laktozë. Në qoftë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, flisni me mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI VITAMINA B1

Gjithmonë merrini tabletat ose tretësirën për injeksion Vitamina B1 vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Vitamina B1 janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Tabletat merren nga goja
Të rriturit: 10 - 20 mg, 1 - 2 herë në ditë.
Fëmijët deri në 1 vjeç: 5 mg në ditë.
Fëmijët 2 - 6 vjeç: 10 mg në ditë
Fëmijët 7 - 12 vjeç: 20 mg në ditë.

Tretësira për injeksion administrohet nën lëkurë, në muskul ose intravenë:
Të rriturit: 50 - 100 mg në ditë.
Fëmijët deri në 1 vjeç: 2.5 - 5 mg në ditë.
Fëmijët 2 - 6 vjeç: 5 - 10 mg në ditë.
Fëmijët 7 - 12 vjeç: 12.5 - 25 mg në ditë.

Përdorimi intravenoz rezervohet për raste shumë të rralla dhe bëhet në mënyrë të ngadalshme me perfuzion për më shumë se 30 minuta.

Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamina B1
Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamina B1 se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Vitamina B1
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Nëse keni pyetje të mëtejshme për këtë produkt, pyesni mjekun ose farmacistin.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjithë barnat e tjera, Vitamina B1 mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Ndonjëherë janë konstatuar të përziera, hemorragji në aparatin tretës, edemë pulmonare, cianozë, edemë angioneurotike, të kruajtura, urtikarie, ndjesi ngrohtësie, djersitje, dobësi, hipotension dhe kolaps kardiovaskular. Këto dukuri zhduken me uljen e dozës ose me ndërprerjen e mjekimit me Vitamina B1 (tiaminë klorhidrat).
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI VITAMINA B1

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Vitamina B1 pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Lënda aktive është tiaminë klorhidrat.

Çfarë përmbajnë tabletat Vitamina B1
Çdo tabletë përmban 10 mg tiaminë klorhidrat.
Përbërësit e tjerë janë: laktozë, celulozë mikrokristalore, acid tartrik, talk, stearat magnezi, glikolat natriumi i amidonit.

Çfarë përmban tretësira për injeksion Vitamina B1
Çdo ampulë 1 ml përmban 50 mg tiaminë klorhidrat.
Përbërësit e tjerë janë: hidrogjenfosfat natriumi, dihidrogjenfosfat natriumi, tioure, acid klorhidrik mund të shtohet për rregullim pH, ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit
Tabletat: kuti me 30 tableta dhe kuti me 60 tableta.
Tretësira për injeksion: kuti me 10 ampula.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Nëntor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.